



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



REPUBLIKA EKOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO	
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE	
REGULATIVNI AUTORITET ŽELEZNICA	
RAILWAY REGULATORY AUTHORITY	
DE/ISEK: DE/ISEK: DE/ISEK:	01
NR PROT: BR PROT: NR PROT:	834
NUMRI I FAQEVË BRUJ STRANA NR OF PAGES	29
DD.MM.VVVV: DD.MM.GGGG: DD.MM.YYYY:	22/12/2017
PRISHTINË / A	

Në bazë të nenit 3 paragrafi 1.41, neni 3 paragrafi 2, neni 101 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

Rregullore Nr. 03/2017, për Metodat e Përbashkëta të Sigurisë (MPS), për Vlerësim dhe Llogaritje të Rrezikut

Rr. Rrustem Statovci nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton një metodë të rishikuar të përbashkët të sigurisë (MPS) për vlerësimin dhe llogaritjen e rrezikut siç referohet në Nenin 3 pika 1.41, Neni 101 pika 2 të ligjit Nr. 04/L-063 për hekurudhat e Republikës së Kosovës, Nenin 6 (3) (a) të Direktivës 2004/49 / EC.
2. Kjo rregullore do të lehtësojë qasjen në tregun e shërbimeve të transportit hekurudhor nëpërmjet harmonizimit të:
 - (a) procesit të menaxhimit të rrezikut që përdoret për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve në nivelet e sigurisë dhe pajtueshmërinë me kërkesat e sigurisë;
 - (b) shkëmbimit të informacionit të rëndësishëm të sigurisë ndërmjet aktorëve të ndryshëm në sektorin hekurudhor në mënyrë që të menaxhojnë sigurinë nga ndikimet e ndryshme të cilat mund të ekzistojnë në këtë sektor;
 - (c) Dëshmimeve (provave) që rezultojnë nga zbatimi i një procesi të menaxhimit të rrezikut.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo rregullore duhet të aplikohet nga propozuesi siç përcaktohet në nenin 3 (11), kur të bëhet ndonjë ndryshim në sistemin tonë hekurudhor. Ndryshime të tilla mund të jenë të natyrës teknike, operative ose organizative. Për sa i përket ndryshimeve organizative, vetëm ato ndryshime të cilat mund të ndikojnë në proceset e operacionale ose të mirëmbajtjes duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit sipas rregullave të nenit 4 të kësaj rregullore.
2. Kur, në bazë të një vlerësimi sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 4 (2) (a) deri në (f):
 - (a) ndryshimi konsiderohet i rëndësishëm, procesi i menaxhimit të rrezikut të përcaktuar në nenin 5, duhet të zbatohet;
 - (b) ndryshimi konsiderohet jo i rëndësishëm, do të jetë e mjaftueshme duke mbajtur dokumentacionin e duhur për të justifikuar vendimin.
3. Kjo Rregullore zbatohet edhe për nën-sistemet strukturore për të cilat zbatohet Direktiva Interoperabilitetit Nr. 2008/57 / EC:
 - (a) nëse një vlerësim i rrezikut është kërkuar nga specifikimet teknike për interoperabilitet (STI), në këtë rast STI kur është e përshtatshme duhet të përcaktojë se cilat pjesë të kësaj rregullore zbatohen;
 - (b) nëse ndryshimi është i rëndësishëm, siç përcaktohet në Nenin 4 (2) të kësaj rregullore, procesi i menaxhimit të rrezikut i përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregullore do të zbatohet për vendosjen në shërbim të nënsistemeve strukturore për të siguruar integrimin e tyre të sigurt në një sistem ekzistues, në bazë të nenit 15 (1) të Direktivës 2008/57 / EC.